



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 22 qershor 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Jasmina Zhivkoviç, Adem Mikullovc, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaku, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Shqipe Pantina dhe Valon Ramadani.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e KPM-së, anëtarët e Bordit të RTK-së, deputeti Salih Zyba, OSBE, KDI, “Koha Ditore”, Radio Kosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2017

Komisioni kërkoi nga anëtarët e KPM-së, të prezantojnë punën e tyre njëvjeçare të përshkruar në raportin vjetor për vitin 2017.

Muja Ferati, kryetar i KPM-së, kërkoi nga komisioni, për arsye se është emëruar rishtazi në pozitën aktuale, raportin ta prezantojë anëtari më i vjetër i KPM-së.

Xhemajl Krasniqi, tha se KPM nuk ka realizuar ndonjë punë të madhe në vitin 2017, përveç nxjerrjes së akteve nënligjore dhe atyre për digjitalizimin, si objektive kryesore e KPM-së për vitin 2018. Objektive tjetër e KPM-së, theksoi edukimin medial, për të cilën çështje kërkoi përkrahjen e Kuvendit.

Xhevahire Izmaku, tha se raporti përmban më tepër përshkrimin e punëve të kryera dhe detyrat e zyrës ekzekutive dhe përshkrimi lidhur me punët e Bordit për Ankesa të Mediave.

Ajo pyeti anëtarët për vizionin që ata ia kanë përcaktuar vetës gjatë mandatit, për procesin e digjitalizimit, si prioritet i KPM-së.

KPM, asnjëherë nuk ka kërkuar përkrahje nga Kuvendi për Strategjinë e KPM-së, që për dy vite radhazi nuk ka kaluar në Qeveri.

Ajo pyeti: A ka kërkuar KPM-ja ndihmë për digjitalizimin, për komunikimin me publikun, pse KPM asnjëherë nuk organizon konferencë për të njoftuar publikun për punën e tyre?

Megjithatë, KPM nuk e ka kryer punën e vet dhe nëse deri në fund të vitit nuk reflektojnë kryerjen e detyrave për digjitalizimin, u deklarua se do ta ngre në Kuvend çështjen e mandatit të tyre.

Milaim Zeka, pati vërejtje në interferencat e tyre gjatë emetimit të emisioneve në “DigitAlb” dhe “Tring”, për platformën në dhënien e licencave dhe kërkoi ngritje të kritereve lidhur me platformën.

Adem Mikullovci, vërejtja e tij ishte në mosmetimin e programeve edukativo-arsimore për fëmijët. Lidhur me këtë, pyeti: Kush e përcakton skemën programore të televizioneve?

Arban Abrashi, kërkoi nga KPM, listën e prioriteteve dhe një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të komisionit.

Salih Zyba, kërkoi sqarime për objektivat e KPM-së për edukimin medial, borxhet e medimeve që kanë ndaj KPM-së, si dhe borxhin që RTK e ka ndaj KPM-së, për licencën.

Nait Hasani, pyeti lidhur me neglizhencën në procesit e nxjerrjes së akteve nënligjore, i cili ka filluar që nga viti 2012 dhe mosimplementimin e akteve nënligjore. Cilat janë masat që KPM-ja ka ndërmarrë ndaj operatorëve ilegalë, të palicencuar.

Imet Rrahmani, pyeti: Sipas parallogaritjes, sa është kostoja për digjitalizimin që do t'i kushtojë Kosovës?

Milaim Zeka, propozoi që raporti t'i kthehet KPM-së për plotësim, me të gjitha vërejtjet e dhëna, dhe pas inkorporimit dhe plotësimit me vërejtje, të kthehet për shqyrtim dhe miratim.

Konstatim: Propozimi u votua unanimisht, komisioni vendosi të mos e miratojë raportin deri në plotësimin e tij nga KPM-ja.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2017

Komisioni kërkoi nga anëtarët e Bordit të RTK-së, që të prezantojnë raportin vjetor për vitin 2017

Afërdita Maliqi, kryetare e Bordit të RTK-së, tha se Bordi ka kryer me përkushtim detyrat në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj, mospërmbushja e detyrave të RTK-së, në përgjithësi, është pasojë e mungesës së buxhetit. Ajo theksoi një ndër problemet e RTK-së, digjitalizimin e arkivit.

Nait Hasani, njoftoi bordin për vërejtjet që KPM-ja dhe qytetarët i kanë për RTK-në, lidhur me skemën programore, mosmbulimin me frekuencë, si dhe kërkesën e diasporës për hapjen e një kanali televiziv për diasporën, në kuadër të RTK-së. Sa do të kushtojë digjitalizimi i RTK-së dhe a ka ndonjë marrëveshje me operatorët?

Imet Rrahmani, pyeti: Si funksionon RTK me 4 kanale dhe sa do t'i kushtojë hapja edhe e një kanali, nëse hapja e një kanali ka koston e vet, pse RTK-ja ka hapur kanale pa mbulim financiar.

Adem Mikullovci, pyeti: Çfarë programesh prodhon RTK-ja, a blen RTK-ja programe artistike, a ka qasje bordi në skemën programore dhe a ka lektor në RTK ?

Xhevahire Izmaku, kërkoi sqarime nga bordi për pamundësinë e realizimit të planeve, për shkak të tranzicionit.

Milaim Zeka, kërkoi nga bordi të jenë ndëshkues të menaxhmentit, në rastet e shkeljeve në RTK, nuk respektohet skema programore, ka defekte në paanshmërinë e moderatorëve, ka mungesë të investimeve në zhvillimin e teknologjisë, për dallim që në vendet tjera, bordet investojnë 20 për qind të buxhetit në zhvillimin e teknologjisë, ndërsa RTK-ja funksionon me një teknologji tejet të vjetër.

Salih Zyba, pyeti: Sa janë borxhet e RTK-së dhe a ka konflikt interesi në RTK?

Nait Hasani - Pse në RTK-2 nuk ka program në gjuhën shqipe, edhe pse duhet të ketë 15 për qind të programeve për komunitetet tjera? Ai kërkoi që ky kanal të plotësohet me program.

Afërdita Maliqi, premtoi se kanali RTK-2 do të plotësohet edhe me program në gjuhën shqipe.

Konstatim: Pas diskutimeve, komisioni unanimisht e miratoi raportin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m:

1. Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2017.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe të nenit 38.4 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 22.6.2018, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Komisioni shqyrtoi propozim-amendamentet e Grupit Parlamentar LS, për nenin 1.11, nenin 5 dhe nenin 9 dhe nuk i miratoi me arsyetimin se komisioni duhet të konsultohet se a mund të propozohet një amendament që nuk është në tekstin e projektligjit.

Jasmina Zhivkoviç, tha se çështjet e propozuara me amendamente janë të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës, ndërsa që këto propozim-amendamente vetëm përforcojnë çështjet e përcaktuara me Kushtetutë.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani